

## Zgjedhjet dhe transformimi institucional në veriun e Kosovës

### Hyrje

Veriu i Kosovës i dominuar nga serbët është në dilemë rreth pjesëmarrjes në zgjedhjet e para lokale të Kosovës, qysh nga shpallja e pavarësisë së saj në shkurt të vitit 2008. Edhe pse Beogradi dhe Prishtina janë pajtuar që zgjedhjet e Kosovës të mbahen edhe në veri, të zhbëhen institucionet paralele, dhe të krijohen institucionet lokale të Kosovës, shumë nga përfaqësuesit e komunitetit serb atje janë skeptik rreth votimit dhe formimit të mëtutjeshëm të institucioneve. Një numër i madh njerëzish parashikojnë një dalje më të ulët se 20 përqind në zgjedhje, dhe parashikojnë sfida të vështira në krijimin e institucioneve të reja lokale. Veçanërisht sfidues do të jetë integrimi i strukturave serbe të sigurisë në veri në strukturat e Kosovës, si dhe vendosja e një bashkëpunimi të vërtetë mes institucioneve lokale në veri dhe autoriteteve qendrore të Kosovës.

Përfaqësuesit e serbëve në veri tregojnë një numër brengash lidhur me zgjedhjet dhe integrimin pasues në institucionet e Kosovës—siç janë humbja e vendeve të punës si pasojë e reduktimit të parashikuar të administratës lokale, gjasat e vogla që policia e Kosovës t'i punësojë të gjithë oficerët policorë që operojnë në veri, pasiguria rreth vendeve të punës për ata të cilët janë të punësuar në kompani publike jooperative në veri, pagat më të ulëta në institucionet e Kosovës krahasuar me ato të Serbisë—por arsyeja kryesore kundër zgjedhjeve të Kosovës mbetet integrimi i tyre në institucionet e një shteti të cilin ata nuk e pranojnë si të tillë.

Për t'i adresuar sfidat e mbajtjes së zgjedhjeve të rregullta në veri, si dhe vështirësitë që priten në vendosjen e institucioneve të reja lokale të Kosovës, prej 13-15 shtator të vitit 2013, CIG ka organizuar në Shkup të Maqedonisë një tryezë të rrumbullakët me përfaqësues politik si dhe aktivistë të shoqërive civile nga Kosova e Serbia, si dhe një diskutim të ndarë për përfaqësuesit e serbëve të Kosovës. Pjesëmarrësit kanë qenë anëtarë të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Partisë së Pavarur Liberale (SLS), Listës së Bashkuar Serbe (JSL), qeverisë së Kosovës dhe zyrës së presidencës; dhe nga Serbia, pjesëmarrës të Partisë Progresive Serbe (SNS), Partisë Demokratike (DS), Partisë Socialiste të Serbisë (SPS), Rajoneve të Bashkuara të Serbisë (URS), Partisë Liberal Demokratike (LDP), qeverisë së Serbisë dhe zyrës së presidentit, si dhe një numër i analistëve nga Kosova e Serbia; si dhe diplomatë evropian e amerikan. Ky ka qenë event i shtatë si pjesë e projektit të CIG mbi veriun e Kosovës. Në pjesën e dytë të shtatorit, CIG ka organizuar aktivitete përcjellëse në Prishtinë e Beograd me pjesëmarrjen e udhëheqësve serb nga veriun e Kosovës, anëtarëve të parlamenteve dhe qeverive të Kosovës e Serbisë, dhe të shoqërive civile.

Ky projekt shërben si një platformë në të cilën përfaqësuesit nga Kosova dhe Serbia shkëmbejnë dhe testojnë idetë, principet, dhe zgjedhjet e politikave. Ky projekt financohet dhe

implementohet në bashkëpunim me Departamentin Federal Zvicran të Punëve të Jashtme dhe Ambasadat e Zvicres në Prishtinë e Beograd.

Për të inkurajuar diskutim të hapur, CIG nuk i atribuon asnjë citat ndonjë personi specifik individualisht. Pjesëmarrësit kanë marrë pjesë në këtë tryezë të rrumbullakët në kapacitetet e tyre personale dhe qëndrimet e tyre jodomosdoshmërisht pasqyrojnë ato të organizatave të cilat ata i përfaqësojnë. Zëvendëspresidenti i CIG Shpëtim Gashi e ka përgatitur këtë raport. Pjesëmarrësit nuk e kanë parë përmbajtjen e raportit dhe së këndejmi, CIG merr gjithë përgjegjësinë për përmbajtjen e tij.

## Zgjedhjet në veri

Zgjedhjet e Kosovës më 3 nëntor janë zgjedhjet e para lokale që organizohen në veri pas pavarësisë së Kosovës. Serbia dhe banorët lokalë serbë në veri kanë organizuar disa zgjedhje të tyre atje dhe kanë krijuar institucione të cilat operojnë në pajtim me ligjet e Serbisë. Zgjedhjet e reja janë rezultat i një marrëveshje të arritur rishtas mes Beogradit e Prishtinës. Edhe pse marrëveshja e Brukselit bën thirrje për zgjedhje lokale në pajtim me ligjet e Kosovës, shumë pjesëmarrës thonë se kjo nuk qartëson se çfarë do të ndodhë me ata të cilët kanë punuar në sistemin paralel serb—nëqoftëse ata të gjithë do të punësohen në institucionet e reja—dhe nuk e shpjegon se në bazë të cilave ligje do të funksionojnë institucionet e reja si dhe marrëdhëniet që do ti kenë ato me Beogradin. Një numër i pjesëmarrësve tjerë, megjithate, kanë thënë se marrëveshja qartazi tregon se institucionet e reja do të operojnë në pajtim me ligjet e Kosovës, por kanë thënë se zyrtarët qeveritarë të Serbisë nuk e pranojnë këtë publikisht për arsye politike.

Disa folës kanë thënë se koha kur është arritur marrëveshja korrespondon me përpjekjet e shtuara të Serbisë për të shënuar progres drejt integritet evropian dhe jo me interesat e popullatës lokale në veri. Megjithate, një numër folësish kanë thënë se kjo mund të jetë e vërtetë, porse zgjedhjet dhe krijimi i institucioneve të pranuar nga Prishtina dhe komuniteti ndërkombëtar janë edhe në interes të komunitetit serb. “Më në fund, veriu do të ketë institucione të njohura nga të gjithë”, ka thënë një folës.

Shumë prej pjesëmarrësve kanë thënë se politikanët duhet të krijojnë një klimë më të mirë për pjesëmarrje në zgjedhje. Zyrtarët e Kosovës dhe Serbisë duhet të përmbahen nga retorika e cila ngrit tensionet dhe provokon popullatën. Disa prej tyre kritikojnë fuqishëm qëndrimin e qeverisë së Serbisë për përkrahjen e vetëm një partie serbe, të njohur si “lista e qeverisë”, duke nënkuptuar kështu se partitë dhe iniciativat tjera serbe nuk përfaqësojnë interesat serbe. Kandidatët për kryetarë komunash duhet të përkrahen dhe të inkurajohen nga të gjitha palët e involvuara në këtë proces. “Disa në qeverinë e Serbisë përkrahin vetëm kandidatët të caktuar duke dëmtuar kështu procesin, veçanërisht në raste kur disa besojnë se vetëm kandidatët të cilët janë në listën e shtetit do të fitojnë vendet e punës dhe benefitet. Nuk është demokratike që qeveria të mundohet t’ua imponojnë qytetarëve mënyrën se si votojnë,” ka thënë një folës. Disa kanë thënë se Prishtina duhet të jetë më fleksibile në lidhje me votimin e serbëve. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Kosovës duhet të japë më shumë informata në lidhje me dokumentet të cilat nevojiten për të votuar, listat e votuesve, dhe të punojnë më afër me OSBE-në. Votuesit duhet të edukohen rreth procesit zgjedhor të Kosovës, në përgjithësi.

Pa një klimë më të favorshme politike, shumë folës kanë parashikuar se dalja në zgjedhje do të jetë tepër e ulët. Disa kanë thënë se në rastin më të mirë, dalja do të jetë rreth 20 përqind. Një folës ka thënë se ekzistenca e barrikadave në veri tregon për mungesën e besimit nga ana e serbëve në veri karshi institucioneve të Kosovës dhe refuzimin për integrim. Votuesve duhet treguar se çfare do të sjellin zgjedhjet, ligjet e kujt do të përdoren për krijimin e institucioneve, çfarë do të ndodhë me vendet e tyre të punës, me kontributet e pensionit, kujdesin shëndetësor dhe shkollimin. ‘Nëse ata nuk marrin përgjigje të sakta në këto çështje, dalja në zgjedhje nuk do të jetë e lartë dhe zgjedhjet nuk do të mund të quhen të suksesshme’, ka thënë njëri nga folësit. Marrëveshja vetëm thotë se zgjedhjet do të mbahen në pajtim me ligjet e Kosovës, por nuk thotë se institucionet do të funksionojnë bazuar në ligjet e Kosovës. Për njerëzit në veri, kjo nuk ka të bëjë me zgjedhjet; e gjitha ka të bëjë me statusin e tyre, me atë nëse do të bëhen kosovarë, apo do të mbeten qytetarë serbë, ka thënë njëri nga diskutuesit.

Një numër pjesëmarrësish nga veriu kanë thënë se pjesëtarët e policisë janë duke refuzuar integrimin në policinë e Kosovës. Ata kanë shtuar se përkatësia etnike e atyre të cilët do t’i udhëheqin institucionet—policinë, gjykatat—nuk është e rëndësishme; ajo që është e rëndësishme është se ligjet e kujt do të përdoren. Një folës ka thënë se edhe nëse serbët do t’i kenë institucionet e tyre por në pajtim me ligjet e Kosovës, kjo nuk do të jetë e pranueshme për serbët. Ai ka thënë se bojkoti do të mund të ishte masovik sepse në mënyrë racionale, njerëzit frikësohen nga e ardhmja e tyre; ekziston një konfuzion i madh.

Pjesëmarrësit kanë inkurajuar Prishtinën dhe Beogradin që të vazhdojnë përkrahjen e tyre për procesin integrues politik në veri. Shumë besojnë se Beogradi ka nën kontroll levat në atë pjesë, por siç kanë thënë disa prej pjesëmarrësve, ai nuk ka kontrollë të plotë. Disa folës nga veriu kanë raportuar se kampanja antivotuese deri më tash është bërë përmes mjeteve demokratike, siç janë billboardet.

Siguria gjatë zgjedhjeve mbetet brenga më serioze. Disa folës kanë thënë se në veri ekzistojnë disa struktura të sigurisë të cilat do të mund ta kërcënonin procesin, dhe kanë sygjerruar që EULEX-i dhe KFOR-i të jenë më aktiv. Ata poashtu kanë rekomanduar që Beogradi duhet të jetë më i vendosur dhe t’u dërgojë një mesazh të qartë atyre që mund të planifikojnë të gjejnë ngushëllim në mjetet e dhunshme.

Për të krijuar klimë të favorshme për zgjedhje të lira dhe të drejta dhe me pjesëmarrje të lartë në veri, pjesëmarrësit kanë propozuar një numër hapash:

1. **Qeveria e Serbisë nuk duhet të mbajë anë mes partive politike serbe të Kosovës që garojnë në zgjedhje.** Një numër i pjesëmarrësve i kanë sygjerruar Beogradit që t’i mbështesë të gjitha partitë partitë serbe në mënyrë të barabartë dhe mos të mbështesë njërin apo tjetrën. Disa prej tyre kanë kritikuar deklaratimet e fundit të zyrtarëve serbë të cilët u bëjnë thirrje votuesve serbë që ta përkrahin të ashtuquajturën ‘listë e qeverisë’. Disa prej tyre kanë thënë se kjo i ndanë politikanët serbë në patriotë dhe tradhëtarë dhe nënkupton që ato parti të cilat nuk janë pjesë e ‘listës’ nuk përfaqësojnë interesat e serbëve. Shumë prej tyre poashtu kanë thënë se partitë serbe, përfshirë këtu edhe partitë në qeveri, do të mund të mbështesnin parti të caktuara, por këtë nuk duhet ta bëjë qeveria e Serbisë. Kjo është lista SNS-SPS, e jo lista e qeverisë.

2. **Prishtina, Beogradi dhe komuniteti ndërkombëtar duhet ta ofrojnë sigurinë e atyre të cilët marrin pjesë në garë dhe të parandalojnë kërcënimin masovik të votuesve.** Policia e Kosovës, EULEX-i, KFOR-i dhe sherbimi inteligjent i Beogradit duhet të bashkëpunojnë për të ofruar siguri për ata të cilët garojnë në këto zgjedhje dhe t'i dobësojnë fushatat kërcënuese. Ata poashtu duhet të bashkëpunojnë ngushtë në ndriçimin e incidentet e fundit të kërcënimeve kundër kandidatëve për zgjedhjet në veri, e sidomos në identifikimin dhe kapjen e vrasësve të oficerit të doganave të EULEX-it. Këto institucione duhet tu dergojnë mesazh të qartë atyre që i kryejnë këto krime, se veprimet e tyre nuk do të kalojnë pa u ndëshkuar, duke vepruar shpejtë dhe duke zgjidhur këto raste.
3. **Prishtina, Beogradi dhe serbët në veri duhet të përmbahen nga deklaratat dhe veprimet provokative gjatë fushatës zgjedhore.** Këta akterë duhet të marrin përgjegjësi për të siguruar zgjedhje të suksesshme dhe për të shmangë deklarata dhe veprime të tilla të cilat do të mund ta minonin daljen në zgjedhje. Prishtina duhet t'u shmanget veprimeve siç janë ndalimi i zyrtarëve serbë për të vizituar Kosovën. Beogradi duhet të fokusohet në çështje të interesit lokal dhe të mos interpretojë pjesëmarrjen si "fuqizim të shtetit serb në Kosovë" por si "fuqizim të komunitetit serb në Kosovë". Kandidatët serbë në veri duhet të fokusohen në çështjet lokale dhe të mos përdorin retorikë nacionaliste gjatë fushatës. Zgjedhjet e suksesshme nuk do të kishin ndikim të madh vetëm në sigurimin e një ardhmërie më të mirë për veriun, por do ti përmirësonin marrëdhëniet mes Beogradit e Prishtinës dhe do të krijonin klimë të favorshme për besim dhe bashkëpunim ndëretnik në gjithë Kosovën.
4. **Prishtina e Beogradi duhet të inkurajojnë një debat të hapur e transparent rreth çështjeve lokale gjatë fushatës zgjedhore dhe tu ndihmojnë të gjithë kandidatëve që të kenë qasje të barabartë në media, veçanërisht në mediat publike.** Në veri nuk ka debat publik. Përveç disa TV stacioneve lokale, shumica e votuesve bazohen në mediat nga Beogradi për tu informuar rreth zgjedhjeve. Infrastruktura e të sapoformuarës RTK 2 në gjuhën serbe është bartur në veri për më pak se një javë. Siç raportohet, kompanitë kablloviqe kanë refuzuar ta kenë kanalën në platformat e tyre për shkak të kërcënimeve. RTK 2 duhet të kthehet në veri, pasi që është një burim i rëndësishëm i informacionit për fushatën e serbëve në Kosovë.

## **Krijimi i institucioneve të reja lokale**

Krijimi i institucioneve të reja lokale në veri—institucionet e para të Kosovës që nga deklarimi i pavarësisë—pritet të jetë sfidues. Sipas ligjeve të Kosovës, komunat kanë autonomi thelbësore në planifikimin dhe shpenzimin buxhetor, por ato poashtu marrin grante qeveritare të cilat janë proporcionale me popullsinë, si dhe disa grante të cilat targetojnë zona të caktuara specifike. Për shembull, një folës ka thënë se jugu i Mitrovicës me rreth 100 mijë banorë pranon rreth 18 milion euro. Por për të pranuar grante të tilla, komunat duhet të pranojnë dhe të bashkëpunojnë me autoritet qendrorë; ende nuk është e qartë se si do të vendoset një bashkëpunim i tillë mes komunave të reja në veri dhe qeverisë së Kosovës. Poashtu, për të marrë pagën e Kosovës, anëtarët e institucioneve lokale duhet të marrin dokumenta të Kosovës.

Një numër i folësve kanë thënë se institucionet e reja lokale do të mund të operonin në bazë të ligjeve të Kosovës, por mund të kenë të njejtin qëndrim karshi Prishtinës sikurse institucionet paralele serbe deri më tash. "Ata do të mund të vazhdojnë të mos i përfillin autoritetet qendrore dhe të marrin urdhëra nga Beogradi". Një folës ka thënë se autoritetet e reja lokale në veri i

rezistojnë pranimit të institucioneve të Kosovës por presin që Beogradi të përmbush premtimet e tij në lidhje me zbatimin e marrëveshjes. Folësi ka theksuar rëndësinë e një administrate funksionale dhe së këndejmi ka rekomanduar që të fillohet me trajnime për punëtorët potencial dhe që t'i kushtohet një vëmendje e veçantë për ofrimin e shërbimeve sociale.

Jo të gjithë pjesëmarrësit janë pajtuar se krijimi i komunave është aq i komplikuar. Një folës ka thënë se pas luftës, shqiptarët e Kosovës është dashur të ndërtojnë gjithçka nga zero por ata e kanë bërë këtë, sepse ka pasë entuziazëm dhe vullnet të mjaftueshëm. "Njerëzit në veri duhet ta kenë vullnetin dhe entuziazmin sepse ata janë duke ndërtuar të ardhmen e tyre", ka thënë ky folës.

Deklaratat publike të disa zyrtarëve qeveritarë të raportuara në media se zgjedhjet dhe krijimi i institucioneve të reja lokale "do të forcojë shtetin e Serbisë në Kosovë" kanë qene brengosëse për disa pjesëmarrës. "Deklarata të tilla sigurisht se nuk krijojnë vullnet dhe entuziazëm", ka thënë një diskutues. Një pjesëmarrës nga veriu ka thënë se opinionet e tij mund të jenë të ndryshme nga ato të atyre të cilët kanë pranuar marrëveshjen e Brukselit, porse megjithate ai do t'i zbatojë vendimet e partisë së tij. Ky folës ka shtuar se për votuesit nuk është e qartë se cila është e ardhmja e tyre, cili do të jetë rezultati përfundimtar i zbatimit të marrëveshjes, çfarë do të ndodhë me vendet e tyre të punës, dhe cili do të jetë statusi i ndërmarrjeve publike dhe punëtorëve të tyre në veri. "Njerëzit janë duke pyetur për gjëra të tilla dhe ne si kandidatë për kyetar komune duhet t'i kemi pergjigjet për këto pyetje". Ai ka konkluduar se nëse dalja në zgjedhje është e ulët, ndërtimi i institucioneve funksionale dhe të besueshme do të jetë i vështirë.

Një tjetër folës është pajtuar se dalja në zgjedhje është e rëndësishme për legjitimitetin e institucioneve. "Këto zgjedhje janë më shumë referendum sesa zgjedhje, referendum për integrimin në sistemin e Kosovës". Ai poashtu ka pritur dalje të ulët në zgjedhje sepse është e vështirë të votosh kur nuk e di se çfarë do të sjellë e ardhmja. "Ekziston një pasiguri e madhe; rezultati i zgjedhjeve është i paparashikueshëm, pjesëmarrja është e paparashikueshme; nuk dihet se sa do të investojë Prishtina në këtë pjesë; dhe njerëzit mendojnë se barra e këtij tranzicioni do të mbahet nga popullata lokale". Ai poashtu ka thënë se disa njerëz në veri kanë ndjenjën e tradhëtisë nga Beogradi, se "ai ka hequr dorë nga ata dhe është duke i hudhur ata në një të panjohur të madhe".

Në lidhje me vazhdimin e financimit nga Beogradi, një folës ka thënë se Serbia nuk ka të holla për të vazhduar dhënien e pagave për serbët e Kosovës. Ai nuk është pajtuar me parafolësin e tij rreth paqartësive në veri. "Paqartësia nuk është problemi me të cilin ballafaqohen serbët në veri, ajo me çka ballafaqohen ata është humbja eventuale e përfitimeve, siç janë pagat e dyfishta". Ai ka parashikuar se çfarëdo fushate për bojkot do të dështojë dhe se procesi zgjedhor do të rrjedhë pa probleme. Por një folës nga veriu ka thënë se arsyeja pse ata kundërshtojnë integrimin në institucionet e Kosovës është "thjesht çështje principi, e jo përfitimi". Një tjetër folës ka thënë se është e vështirë të shihet se sa është për principe dhe sa për përfitime, por gjithsesi është një përzjerje e të dyjave.

Cështja e legjitimitetit dhe daljes në zgjedhje është diskutuar nga një numër i folësve. Njëri prej tyre ka theksuar se përkrahja politike nga të gjitha anët do të mund të krijonte legjitimitet, e jo vetëm dalje në zgjedhje. Për shembull, shumë e kanë konsideruar "SLS-në jolegitime kur i

kishte marrë vetëm rreth 1,000 vota dhe kur i kishte marrë 15,000 vota”. Ai ka theksuar se kryetarët e komunave do të jenë legal pavarësisht përqindjes së atyre që dalin në zgjedhje. “Vetëm shtate mijë njerëz kanë votuar në zgjedhjet serbe në veri të Mitrovicës por kryetari i komunës është njohur si legal dhe legjitim”, ka thënë një folës. Ai është pajtuar me folësit tjerë rreth paqartësive për të ardhmen, por ka shtuar se “ne do të mund të krijojmë një ambient më të qartë”. Njerëzit në veri duhet të angazhohen më shumë dhe të gjejnë përgjigje e të krijojnë ambient të qartë e të sigurtë, e jo vetëm të presin që gjithçka të bëhet nga Brukseli, Prishtina e Beogradi. Ai poashtu ka parashikuar se Beogradi do ta ndërpresë financimin e tij për veriun por “jo pse marrëveshja e Brukselit nuk e lejon një gjë të tillë, por për shkak se qeveria nuk ka fonde”. Mesazhi i tij për autoritetet e Kosovës ka qenë që ata do të duhej ta mbështesnin veriun financiarisht dhe politikisht, dhe ta “trajtojnë atë si territor dhe popullsi të veten”.

Për të krijuar institucione funksionale dhe të pranueshme për serbët në veri, pjesëmarrësit kanë propozuar një numër hapash:

1. **Të gjitha palët do të duhej të fokusoheshin në krijimin e stabilitetit politik në veri.** Stabiliteti në veri është faktori kryesor për tërheqjen e investimeve dhe krijimin e jetës më të mirë për njerëzit atje. Njerëzit do ta përkrahin procesin politik më shumë kur shohin ndryshime reale siç janë sisteme më të mira të ujërave, rrugë më të mira dhe shërbime tjera. Por, për të krijuar stabilitet, serbët në veri do të duhej të bashkëpunonin me Prishtinën, Beogradin dhe komunitetin ndërkombëtar. Në anën tjetër, Prishtina, Beogradi dhe komuniteti ndërkombëtar duhet të provojnë ta zbusin koston e tranzicionit duke e bërë të mundshme qasjen në mikrofinanca, kredi për bizneset e vogla dhe duke inkurajuar investime private. Votuesit në veri duhet ta dijnë se çka janë duke përfutur nga integrimi, dhe jo vetëm çka do të humbin nga ai. Ata duhet ta dijnë se si do të përmirësohen gjërat, dhe sa para do të hyjnë në veri. Mungesa e qartësisë në mendjet e njerëzve rreth së ardhmes është një nga pengesat më serioze për suksesin e procesit integrues.
2. **Organizatat ndërkombëtare, si OSBE-ja, duhet të organizojnë trajnime për zyrtarët e administratës lokale.** Pranimi politik i institucioneve të reja nga serbët në veri është i rëndësishëm, por palët e involvuara lokale e ndërkombëtare do të duhej të fokusoheshin në ndërtimin e një administrate lokale efikase dhe profesionale. Shërbimet efikase do ta rrisnin besueshmërinë e këtyre institucioneve në sytë e publikut dhe do ti zbusnin kundërshtimet politike të cilat i kanë serbët në veri kundrejt institucioneve lokale të Kosovës. Në këtë aspekt, Prishtina dhe organizatat ndërkombëtare në Kosovë, si OSBE-ja, Komisioni Evropian, ambasadat, duhet t’i mbështesin programet trajnuese për stafin administrativ.
3. **Fonde aktive për komunat.** Prishtina do të duhej t’ua transferonte financat autoriteteve komunale menjëherë pas zgjedhjeve, për ta bërë sa më të rregullt procesin e formimit institucional.
4. **Vendosja e marrëdhënieve të punës me institucionet qendrore të Kosovës.** Pjesa më e madhe e buxheteve komunale vjen nga grantet e qeverisë së Kosovës, për shkak se të hyrat lokale janë të vogla. Kjo do të ndodhë edhe me komunat në veri. Së këndejmi, është shumë e rëndësishme të vendoset një marrëdhënie e mirë me institucionet qendrore në mënyrë që të pranohen grantet në kohë dhe që të kërkohen fonde specifike për fusha të caktuara që kanë më së shumti nevojë.

## **Pjesëmarrësit e takimit në Shkup**

**Vladimir Bozovic**, Qeveria e Serbisë  
**Ilir Deda**, Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave  
**Nenad Djuric**, Policia e Kosovës  
**Sadri Ferati**, Lidhja Demokratike e Kosovës  
**Ardian Gjini**, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës  
**Dukagjin Gorani**, Instituti Liberal Demokratik  
**Adrijana Hodzic**, Qeveria e Kosovës  
**Dusan Janjic**, Serbia Aktive  
**Marko Jaksic**, Avokat, Mitrovicë  
**Rada Kapetanovic**, Gjykatës, Zubin Potok  
**Dusan Kozarev**, Zyra e Presidentit të Serbisë  
**Leon Malazogu**, Instituti Demokraci për Zhvillim  
**Milivoje Mihajlovic**, Qeveria e Serbisë  
**Ljubisa Mijacic**, Zubin Potok  
**Petar Miletic**, Partia e Pavarur Liberale  
**Smiljka Milisavljevic**, Universiteti në Mitrovicë  
**Randjel Nojkic**, Lëvizja e Ripërtirjes Serbe  
**Zoran Ostojic**, Partia Liberal Demokratike  
**Krstimir Pantic**, Partia Progresive Serbe  
**Xhemajl Pecani**, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Kosovës  
**Gazmir Raci**, Qeveria e Kosovës  
**Dejan Radenkovic**, Partia Socialiste e Serbisë  
**Nenad Radosavljevic**, Rrjeti i TV Stacioneve Serbe në Kosovë  
**Naim Rashiti**, Grupi i Ballkanit për Hulumtim të Politikave  
**Besa Shahini**, Iniciativa Evropiane për Stabilitet  
**Predrag Simic**, Universiteti i Beogradit  
**Nexhmedin Spahiu**, Analist Politik  
**Jelena Trivan**, Partia Demokratike  
**Arber Vlahiu**, Zyra e Presidentes së Kosovës  
**Danijela Vujcic**, Rajonet e Bashkuara të Serbisë  
**Shpetim Gashi**, Këshilli për Qeverisje Inkluzive  
**Alex Grigorev**, Këshilli për Qeverisje Inkluzive  
**Oliver Hoehne**, Departamenti Federal për Punë të Jashtme i Zvicrrës  
**Krystyna Marty**, Departamenti Federal për Punë të Jashtme i Zvicrrës  
**Raphael Naegeli**, Task-forca e drejtuar nga OSBE, Departamenti Federal për Punë të Jashtme i Zvicrrës  
**Igor Novakovic**, Këshilli për Qeverisje Inkluzive  
**Jean-Daniel Ruch**, Departamenti Federal për Punë të Jashtme i Zvicrrës  
**Norbert Ruetsche**, Departamenti Federal për Punë të Jashtme i Zvicrrës  
**Mark Tervakoski**, Departamenti Amerikan i Shtetit  
**Samuel Zbogar**, Komisioni Evropian